

## NGRITJA E KALLËZIMEVE PENALE NGA DREJTORIA DOGANORE NË SHTATOR 2009

Për shkak ekzistimit të dyshimeve të arsyeshme për bërjen e veprave penale:kontrabandë,importi ose lëshimi në qarkullim të mallrave akcizë dhe prodhimi i paligjshëm,mbajtja dhe tregtimi i armëve ose lëndëve shpërthyesë dhe mashtrim doganor, Drejtoria doganore deri tek Prokuroria publike në shtator 2009 ka ngritur 11 akuza penale kundër 4 personave juridik dhe 13 kundër personave fizik.

- Një kallëzim penal është ngritur kundër dy personave fizik me iniciale G.SH dhe E.SH që të dy shtetas të Maqedonisë nga Prilepi,për bërjen e veprës penale Kontrabandë sipas nenit 278 paragrafi 1 nga Kodi penal,sepse me datë 19.09.2009 në pikën kufitare Deve Bair në hyrje për në RM si udhëtar në autobus me targa të Turqisë kanë tentuar joligjerisht të fusin 175 copë stoli arri dhe argjendi,4 peshore argjendari dhe 3 katalogje për stoli. Sipas mendimit profesional nga argjendaria Rubin stolit e padeklaruara janë prej ari dhe argjendi me vlerë prej 414.971,06 denarë.
- Katër kallëzim penal janë ngritur kundër katër personave fizik për import ose lëshimi në qarkullim të mallrave akcizë e cila është vepër penale sipas 60 nga Ligji për akciza.ku:
  - Një kallëzim penal është ngritur kundër personit me iniciale G.Z shtetas i Bullgarisë,për arsye se gjatë kontrollit detal të automjetit me targa të Bullgarisë, ndërsa në pronësi të një shtetasi tjetër të Bullgarisë,të kryer në pikën kufitare Bogorodicë në hyrje për në RM,janë zbuluar 18 steka cigare Karelia Slims pa pulla kontrolluese,më vlerë prej 10,728,00 denarë,i cili kishtë bërë përpjekje për të shmangur pagesën e taksave në shumë prej 19.314.00 denarë.
  - Një kallëzim penal është ngritur kundër personit me iniciale F.A shtetas i Maqedonisë,për arsye se gjatë kontrollit detal të kamionit me targa të Maqedonisë ,të kryer 21.08.2009 në pikën kufitare Bogorodicë në hyrje për në RM,në kabinën e kamionit më sakstësisht nën tapacir, janë zbuluar 19 steka cigare Karelia Slims pa pulla kontrolluese,më vlerë prej 11.324,00 denarë,i cili kishtë bërë përpjekje për të shmangur pagesën e taksave në shumë prej 17.199.00 denarë.
  - Një kallëzim penal është ngritur kundër personit me iniciale G.D shtetas i Maqedonisë,për arsye se gjatë kontrollit doganor të kryer 12.09.2009 në pikën kufitare Tabanovc në hyrje për në RM,në torbën e udhëtimit që i dyshuari e kishte me vete,janë zbuluar 30 steka cigare Fast,Ronhill,Classik,Lucky strike,Mallboro dhe West,pa pulla kontrolluese,më vlerë prej 12.000,00,denarë,i cili kishtë bërë përpjekje për të shmangur pagesën e taksave në shumë prej 20.799,00 denarë.
  - Një kallëzim penal është ngritur kundër personit me iniciale I.L shtetas i Kosovës,për arsye se gjatë kontrollit detal të automjetit me targa të Kosovës në pronësi të personit,të kryer 09.09.2009 në pikën kufitare Jazhincë në hyrje për në RM,në karriget e përparme dhe të pasme,janë zbuluar 20 steka cigare West Lights,pa pulla kontrolluese,më vlerë prej 9.824,00 denarë,i cili kishtë bërë përpjekje për të shmangur pagesën e taksave në shumë prej 15.331.00 denarë.
- Dy kallëzime penale janë ngritur kundër tre personave fizik për bërjen e veprës penale prodhim të paligjshëm,mbajtja dhe tregtia me armë ose materieve shpërthyesë sipas nenit 396 paragrafi 1 nga Kodi penal.ku:

- Një kallëzim penal është ngritur kundër dy personave me iniciale A.H dhe S.D shtetas të Maqedonisë për arsye se gjatë kontrollit detal të autobusit me targa të Shqipërisë në pronësi të një firme nga Tirana, të kryer me 20.08.2009 në pikën kufitare Qafthanë në hyrje për në RM, në hapësirate brendshme të autobusit (nën vendin e ngasësit, nga ana e derës së ngasësit) janë zbuluar 140 copë municion pishtolli kalibër 7,62 mm të paketuara në qese. Sipas ekspertizave të kryera MPB-Spektori për teknikë krimi, është konstatuar se malli i konfiskuar është municion (plumba) me kalibër 7.62x25mm me prejardhje Kineze, të dedikuara për armë ruese gjysëm-automatike “Tokarev TT” dhe verzionet e tij si dhe për disa modele të armëve zjarri automatike.
  - Një kallëzim penal është ngritur kundër një personi me iniciale D.P shtetas i Maqedonisë, për arsye se gjatë kontrollit të automjetit me targa të Maqedonisë, i cili e ka drejtuar të kryer me 03.08.2009 në pikën kufitare Dellçevë-në hyrje për në RM është zbuluar armë zjarri dhe municion të padeklaruar. Ekspertizat e kryera nga ana e MPB-Spektori për teknikë krimi ka konstatuar se bëhet fjalë për armë dhe municion.
- Katër kallëzime penale janë ngritur kundër katër personave juridik dhe kundër katër personave fizik për bërjen e veprës penale “Mashttrim doganor” sipas nenit 278-a nga Kodi penal, ku:
    - Një kallëzim penal është ngritur kundër personi juridik nga Manastiri dhe personit përgjegjës S.D nga Manastiri për arsye se kanë dashur të shmangen pagesës së të dhënave doganore dhe të dhënave tjera në shumë prej 251.590,00 denarë. Pikërisht, në procesin e shlyerjes së importit të përkohëshëm për përpunimin e një sistemi të shtyrë të pagesës së të dhënave doganore, kanë treguar sasi të madhe të materialeve të përdorura për prodhimin e produkteve finale, të cilat i kanë eksportuar me shumë deklarata doganore eksportuese. Gjatë kontrollit të gjendjes së importit të përkohëshëm dhe mënyrën e shlyerjes së tij (për periudhën 2007-2008) në kompaninë tregtare dhe në depon ku janë të vendosur mallrat, është konstatuar tepriçë të mallit në depon të cilat janë deklaruar si mallra të shlyera, për të cilat gjatë procedurës së importit nuk janë paguar të dhënat doganore. Personi juridik nuk është përmbajtur tek obligimet të ndërmarra me marrjen e lejes për përdorimin e procedurës doganore për import për fisnikërim dhe është i obliguar që ta paguaj dallimin e të dhënave të shmanguar me vendim në procedurë administrative.
    - Një kallëzim penal është ngritur kundër personi juridik nga Strumica dhe personit përgjegjës të tij A.SH nga Strumica për arsye se kanë dashur të shmangen pagesës së të dhënave doganore dhe të dhënave tjera në shumë prej 14.623.159,00 denarë, me paraqitjen e faturave të rreme në të cilat vlera e mallrave është treguar jorealisht e ulët. Gjegjësisht, të dyshuarit me tetë deklarata doganore në vitin 2004 dhe 2005 kanë paraqitur për doganim mall të ndryshëm teknik të importuar nga Austria, ku nuk e kanë treguar vlerën e realt të mallit me parashtrimin e faturave me bazë të pabesueshme dhe me kosto të ulët për llogaritjen e detyrimeve të impotrit. Drejtoria doganore, përmes shërbimit për vlera doganore, i ka dërgar faturat lëndore në kontroll tek shërbimi doganor i Austrisë, e cila informoi se të njëjtët dallohen nga faturat e lëshuara nga ana e eksportuesit edhe atë në vend të shëmës së deklaruar tek organo dohanor prej 189.874,00 dollar amerikan e njëjta arrin 690.644,00 dollar amerikan. Me vendim nga procedura administrative ,personi juridik është i obliguar që ta paguaj dallimin e të dhënave të ikura doganore.
    - Një kallëzim penal është ngritur kundër personi juridik nga Struga dhe personit përgjegjës të tij T.P nga Struga, për arsye se kanë dashur të shmangen pagesës së të dhënave doganore dhe të dhënave tjera në shumë prej 321.273,00 denarë, me paraqitjen e faturave të rreme në të cilat vlera e mallrave është treguar jorealisht e ulët. Gjegjësisht, të dyshuarit me shtatë deklarata doganore në vitin 2004, 2005 dhe

2006 kanë paraqitur për doganim mall të ndryshëm të importuar nga Turqia, ku nuk e kanë treguar vlerën e realt të mallit me parashtrimin e faturave me bazë të pabesueshme dhe me kosto të ulët për llogaritjen e detyrimeve të impotrtit. Drejtoria doganore e Turqisë deri tek Drejtoria doganore e Maqedonisë ka dorguar kërkesë për kontrollin e faturave lëndore në raport të deklaruarve gjatë importit në Maqedoni, ku nga ana e repartit për hetim është konstatuar se të njëjtat dallohen nga faturat e paraqitura gjatë doganimit të mallrave edhe atë në vend të shumës së deklaruar tek organet doganore të Maqedonisë prej 35.178,36 euro e njëjta arrin gjithsejtë 58.142,68 euro. Me vendim nga procedura administrative ,personi juridik është i obliguar që ta paguaj dallimin e të dhënave të ikura doganore.

- Një kallëzim penal është ngritur kundër personi juridik nga SHkupi dhe personit përgjegjës J.P nga Republika e Greqisë për arsye se kanë dashur ti shmangen pagesës së të dhënave doganore dhe të dhënave tjera në shumë prej 297.444,00 denarë. Në vitin 2009 gjatë zbatimit të procedurës importuese kanë dhënë informata të rejshme për klasifikimin e mallit në shenjë tarifore. Gjegjesisht, me tre deklarata doganore të akuzuarit kanë kryer import të metilit tetra butil etel të klasifikuar në numër tarifor me shkallë të doganës prej 0% dhe TVSH ME shkallë prej 18%. Për shkak të dyshimit në klasifikimin e mallrave janë marrë mostra dhe pas analizave të bëra është konstatuar se malli klasifikohet në numër tjetër tarifor për të cilin shkalla doganore është 5% dhe TVSH 18%. Me vendim nga procedura administrative ,personi juridik është i obliguar që ta paguaj dallimin e të dhënave të ikura doganore.